



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:050136

Datë: 27.02.2024

Numri i dokumentit: 05377661

C.nr.4149/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.D., S.Sh., P.P., M.B. dhe V.B. që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku” me avokatët e saj nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, me objekt kontesti kompensimin i pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,000.00 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësorë, me datë 27 Shkurt 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve S.D., S.Sh., P.P., M.B. dhe V.B. që të gjithë nga Prizreni, dhe **DETYROHET** e paditura Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, që paditësit në emër të shpërblimit jubilar të i kompensoj:
- Paditëses S.D. në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në punë, në vlerë të një page mujore të saj, t’ia kompensoj shumën prej **377.00 euro** dhe
 - Paditësit P.P. në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës në punë, në vlerë të një page mujore të tij, t’ia kompensoj shumën prej **659.77 euro**;
- II. **DETYROHET** e paditura Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren, që paditësve S.D. dhe P.P. të ua paguaj **shumën e përgjithshme prej 1,036.77 euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (16.03.2022), e deri në pagesën definitive si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës, shumën prej 176.00 euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve S.Sh., M.B. dhe V.B. me të cilën kanë kërkuar që të: *“DETYROHET e paditura Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim.Dr.Daut Mustafa”, në Prizren, që paditësve në emër të shpërblimit jubilar të ua paguajë: paditëses S.Sh. për 10 vite të përvojës në punë, në vlerë të një page mujore të saj, t’ia kompensoj shumën prej prej 659.77 euro, paditësit M.B. për 20 vite të përvojës në punë, në vlerë të dy pagave mujore të tij, t’ia kompensoj shumën prej 850.00 euro dhe paditëses V.B. për 10 vite të përvojës në punë, në vlerë të një page mujore të saj, t’ia kompensoj shumën prej 425.00 euro, të gjitha këto shuma me kamat ligjore prej 8% nga dita e ushtrimit të padisë, e gjerë në pagesën definitive” e pabazuar.*

Arsyetim

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ...” me avokatët e saj nga Prishtina, në këtë Gjykatë me datën 16.03.2022 kanë parashtruar padi për kompensimin të pagës jubilar kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Rajonal “Prim.Dr.Daut Mustafa” në Prizren.

Në padi, i autorizuari i paditësve ka theksuar se paditësit janë të punësuar në Spitalin Rajonal në Prizren, dhe të njëjtëve nuk u janë paguar pagat jubilar. Sipas të autorizuarit të paditësve, bazuar në nenit 17 par.3, punëtorët (Anëtarët e FSSHK-ut) në vitet jubilar të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerën e caktuar sikurse në Kontratën Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018. Sipas tij në bazë të vërtetimeve për përvojën e punës të lëshuara nga Spital Rajonal Prizren, për pagën jubilarë paditëses S.D. ka 11 vite, 2 muaj dhe 28 ditë përvojë pune i takon një page bazë, paditëses S.Sh. ka 12 vite, 7 muaj, dhe 18 ditë përvojë pune i takon një page bazë, për paditësin P.P. ka 12 vite, 7 muaj dhe 18 ditë përvojë pune i takon një page bazë, për paditësin M.B. ka 20 vite përvojë pune i takon dy page bazë, për paditësen V.B. ka 15 vite përvojë pune i takon një page bazë. Në fund gjykatës i ka propozuar, që e njëjta të merr aktgjykim dhe padinë e kërkesëpadinë e paditëseve ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar. Në këtë drejtim, ka shtuar se kërkesëpadija e paditësve është parashkruar pasi që në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej tre (3) vitesh, kurse me dispozitat nga par.3 të këtij neni të Kontratës Kolektive është paraparë që shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, kjo do të thotë se shpërblimet jubilarë paguhet në afat prej një muaji prej ditës kur i punësuari mbush 10, 20 dhe 30 vite përvojë pune të pandërprerë me rastin e jubileut të

ashtuquajtur vit jubilar. Ka theksuar se paditësja S.D. marrëdhënien e punës tek e paditura ka krijuar me datën 01.04.2010 dhe se tek e paditura 10 vjet të përvojës së punës i ka mbushur më datën 01.04.2020, andaj ky vit ka qenë vit jubilar, andaj të njëjtën gjykata duhet ta refuzon. Për paditësen S.Sh. e njëjta marrëdhënien e punës e ka themeluar më datën 01.12.2008, ku 10 vite të përvojës punës i ka mbushur më datën 01.12.2018, por jo në Spitalin e Prizrenit, andaj e kundërshton kërkesëpadinë e paditëses. Për paditësin P.P. i njëjti marrëdhënien e punës e ka themeluar më datën 01.05.2009, ku 10 vite të përvojës punës i ka mbushur më datën 01.05.2019, por jo në Spitalin e Prizrenit, andaj e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit. Për paditësin M.B. marrëdhënien e punës tek e paditura ka krijuar me datën 01.10.2001 dhe se tek e paditura 10 vjet të përvojës së punës i ka mbushur më datën 01.10.2011, andaj ky vit ka qenë vit jubilar, ku nuk ka qenë në fuqi MPKK-ja. Për paditësen V.B. marrëdhënien e punës tek e paditura ka krijuar me datën 31.12.2018, ndërsa përvojën tjetër të punës e ka jo në Spitalin e Prizrenit. Andaj sipas kësaj paditësve nuk u takon e drejta në pagesën e shpërblimit jubilar dhe për këtë arsye ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, kjo gjykatë ka marrë aktgjykim C.nr.915/2022 të datës 31 Tetor 2022, sipas të cilit në pikën nën II të këtij vendimi është aprovuar kërkesëpadia e paditësve si e bazuar.

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.8067/2022 të datës 09.11.2023, është prishur aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prizren, C C.nr.915/2022 të datës 31 Tetor 2022 dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Duke vepruar sipas aktvendimit Ac.nr.8067/2022 të datës 09.11.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Gjykata Themelore në Prizren, analizuar eshë një here shkresat e lendes, në të cilin janë marrë parasysh dhe është vepruar sipas vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të lartcekur.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, e cila bie në kompetencë të paditurës.

Gjykata përmes kontratës për marrëdhënien e punës me numër të amzës 800 dhe me titull të postit H-59 e datës 31.12.2018, ka vërtetuar faktin se paditësja V.B. ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren në vendin e punës Infermiere në repartin e Emergjencës, ndërsa nga Lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës e datës 31.12.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka 15 vite përvojë pune, kurse paga e fundit bazë është 425.00 euro.

Gjykata përmes kontratës për marrëdhënien e punës me numër të amzës 661 dhe me titull të postit H-59 e datës 01.01.2013, ka vërtetuar faktin se paditësi M.B. ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren në vendin e punës Infermier në repartin e Emergjencës. Nga vërtetimi nr.661 i datës 14.12.2020, i lëshuar nga e paditura, për paditësin M.B. nga Prizreni, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren është në marrëdhënie pune nga data 01.10.2001, kurse paga e fundit bazë është 425.34 euro.

Gjykata përmes kontratës për marrëdhënien e punës me numër të amzës 1384 dhe me titull të postit H-20 e datës 13.01.2020, ka vërtetuar faktin se paditësi P.P. ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren në vendin e punës Mjek Specialist-Gjinekolog. Nga vërtetimi nr.1384 i datës 23.02.2022, i lëshuar nga e paditura, për paditësin P.P. nga Prizreni, gjykata vërtetoi faktin se i njëjti në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren, ka 2 vite e 0 muaj e 18 ditë përvojë pune, kurse pjesa tjetër e përvojës prej 10 vite e 7 muaj dhe 0 ditë nuk është në këtë spital, pra gjithsej përvoja e punës është 12 vite, 7 muaj e 18 ditë, kurse paga e fundit bazë është 659.77 euro.

Gjykata përmes kontratës për marrëdhënien e punës me numër të amzës 1409 dhe me titull të postit H-20 e datës 01.03.2021, ka vërtetuar faktin se paditësja S.Sh. ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren në vendin e punës Mjek Specialist-Gjinekologe. Nga vërtetimi nr.1409 i datës 23.02.2022, i lëshuar nga e paditura, për paditësen S.Sh. nga Prizreni, gjykata vërtetoi faktin se e njëjta në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren ka 0 vite e 11 muaj e 1 ditë përvojë pune, kurse pjesa tjetër e përvojës prej 12 vite e 2 muaj dhe 28 ditë nuk është në këtë spital, pra gjithsej përvoja e punës është 13 vite, 2 muaj e 0 ditë, kurse paga e fundit bazë është 659.77 euro.

Gjykata përmes kontratës për marrëdhënien e punës me numër të amzës 1177 dhe me titull të postit H-68 e datës 01.01.2013, ka vërtetuar faktin se paditësja S.D. ka krijuar marrëdhënie pune më të paditurën në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren në vendin e punës Teknike e Farmacisë. Nga vërtetimi nr.1177 i datës

07.02.2022, i lëshuar nga e paditura, për paditësen S.D. nga Prizreni, gjykata vërtetoi faktin se e njëjti në Spitalin Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren ka gjithsej përvojë të punës 11 vite, 10 muaj e 0 ditë, kurse paga e fundit bazë është 377.00 euro.

Kontratat e punës dhe vërtetimet e lartcekura, Gjykata i pranoi si prova materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1 të LPK-së në të cilin paragraf përcaktohet se "Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të". Andaj meqë këto janë dokumente të lëshuara nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e të cilat edhe si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur ashtu që vërtetimet e lëshuar nga Spitali Rajonal "Prim. Dr. Daut Mustafa" në Prizren si prova me të cilat vërtetohen faktet lidhur me përvojën në punë të paditësve, Gjykata ua fali besimin e plotë.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 12.06.2018 dhe ka qenë e zbatueshme deri me datën 10.06.2021.

Me nenin 17 para.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në Kosovë është paraparë se "Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë: "3.1. Për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij; 3.2. Për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij; 3.3. Për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij".

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve Simla Demaj dhe Petrit Pupa t'ua paguaj kompensimin për pagat jubilarë, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive Sektoriale, e në kuptim të Nenit 55 para.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, duke i njohur shumën si në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: "Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë", pasi që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësve S.D. dhe P.P. ju ka buruar e drejta për të

kërkuar shpërblimin jubilar në vlerë të 1 (një) page mujore, ngase kjo kontratë ka qenë në fuqi në momentin kur paditësit kanë arritur të drejtën për të kërkuar pagimin e shpërblimit jubilar, duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 4 i Kontratës Kolektive Sektoriale në të cilin thuhet se “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë, pasi paditëses S.D. i takon e drejta në kompensimin e pagës jubilarë pasi e njëjta në bazë të vërtetimit të lartcekur të lëshuar nga e paditura, vitin jubilar (10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore) e ka arritur me datë 31.01.2021, dhe paditësi P.P. i takon e drejta në kompensimin e pagës jubilarë pasi i njëjti në bazë të vërtetimit të lartcekur të lëshuar nga e paditura, vitin jubilar (10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore) e ka arritur me datë 31.06.2019, në kohën kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale (11.06.2018 -10.06.2021).

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja S.Sh. padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 16.03.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar kërkesa nga data 16.03.2019, ndërsa e njëjta vitin jubilar - 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore e ka arritur me datë 31.11.2018, sipas llogaritjes së gjykatës, kjo kërkesë është parashkruar.

Gjykata e refuzoj si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve M.B. dhe V.B. duke marrë për bazë Mendimin Juridik, për Shpërblimin Jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të datës 27.02.2023, pasi erdhi në përfundim se paditësi M.B. 20 vite të përvojës së punës i ka arritur me datën 01.10.2021 dhe paditësja V.B. 10 vite të përvojës së punës i ka arritur me datën 01.12.2016, në kohën kur nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë e datës 12.06.2018 e cila ka qenë në fuqi deri me datë 10.06.2021. Në rrjedhën e kësaj çështje, është vërtetuar fakti se paditësit sipas vërtetimeve të lëshuar nga e paditura të cilat paditësit ja kanë bashkangjitur shkresave të lëndës, vitet jubilarë i kanë arritur jashtë kohës kur ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par.

1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtimit të padisë (16.03.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifatat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 156.00 euro për përpilimin e padisë, si dhe për taksën gjyqësore shumë prej 20.00 euro, gjithsej shumë prej 176.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.4149/2023, me datë 27 Shkurt 2024

G j y q t a r i

Gëzim Shehu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.